

V E N D I M
Nr.527, datë 17.10.1994

**PËR DISA SHITESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.577, DATË 6.12.1993 “PËR NDËRTIMIN, SHPËRNDARJEN DHE ADMINISTRIMIN E
BANESAVE QË NDËRTOHEN NGA NDËRMARRJET SHTETËRORE ME FITIMET E
TYRE”**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.577, datë 6.12.1993, pika 1 ndryshohet si vijon:
“Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore kanë të drejtë të ndërtojnë banesa për strehimin e punonjësve të tyre, duke përdorur si burim financiar fitimet e veta, pas miratimit nga organi prej të cilit varen”.
 2. Në pikën 2 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:
“Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore që ndërtojnë banesa për punonjësit e tyre me fitimet e veta, depozitojnë pranë Entit Kombëtar të Banesave fondet e planifikuara për këtë qëllim.”
 3. Pika 5 ndryshohet si vijon:
“Shitja e banesave të sipërpërmendura të bëhet në bazë të kritereve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.291, datë 21.6.1994 “Për kriteret e vlerësimit të apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”, dhe udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 22.8.1994“Për vlerësimin e apartamenteve që ndërtohen me fonde shtetërore”.
 4. Shtohet pika 8 me këtë përmbajtje:
“Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore të vënë në dispozicion të Entit Kombëtar të Banesave gjithë dokumentacionin teknik. Projektet e banesave do të zgjidhen sipas kritereve të njëllojta që përdor Enti Kombëtar i Banesave, duke u bazuar në normativat shtetërore të projektimit në fuqi”.
 5. Shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:
“Ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore ndërtojnë banesa vetëm për punonjësit që konsiderohen të pastrehë. Në rast se ndërmarrja apo institucioni shtetëror nuk kanë punonjës të pastrehë, mund të ndërtojnë banesa për përmirësimin e kushteve të banimit të punonjësve të tyre”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi